



Nr. __ Prot.

Tiranë, më _____

RAPORT REKOMANDUES

Lënda: Për miratimin e kërkesës së Prokurorisë “Për dhënie autorizimi për “Për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.”

Drejtuar: Seancës Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, hartuar nga deputeti, anëtar i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Enkelejd Alibeaj.

I.HYRJJE

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 12.12.2023 është vënë në lëvizje nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Kjo e fundit, me shkresën nr. 16688 prot., datë 12.12.2023, ka kërkuar nga Kuvendi, dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit, ndaj deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Sali Berisha. Kjo kërkesë e prokurorisë shoqërohet nga:

1. relacioni përkatës i arsyetuar, me anë të të cilit parashtrohet se SPAK, ka rregjistruar procedimin penal nr. 287 te vitit 2020. Në kuadër të këtij procedimi, janë marrë vendime nga GJKKO (respektivisht shkalla e parë ka dhënë vendimet nr. 112 dt. 20.10.2023 “për caktimin e masave të sigurimit” dhe vendimin nr. 117, dt. 26.10.2023 “për marrjen në pyetje të personit në hetim”, kurse shkalla e dytë ka marrë vendimin 56 (87-20-23-156), dt. 21.11.2023 “për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimeve të shkallës së parë”. Sipas vendimeve të mësipërme, është vendosur që ndaj deputetit që është në statusin e personit në hetim janë caktuar masat e sigurimit personal shtrënguese: 1- “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore” (neni 234 i KPP) dhe 2- Ndalimi i daljes jashtë shtetit (neni 233 i KPP). Në bazë të këtyre masave, personi në hetim, ka patur detyrimin që të paraqitej të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00 para oficerit të policisë gjyqësore, Adelajda Metaj, pranë SPAK (detyrime sipas masës së parë) dhe detyrimin të mos largohet nga

territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizim të gjykatës (detyrim sipas masës së dytë).

2. 3 (tre) proces verbale, “mbi paraqitjen e shtetasit Sali Berisha”, respektivisht i datave 06.11.2023, ora 16:00, i datës 20.11.2023, ora 16:00, i datës 04.12.2023, ora 16:00. Të tre procesverbalet përpiluar dhe nënshkruar nga oficeri i policisë gjyqësore Adelajda Metaj (vulosur dhe nënshkruar).
3. Vendim i GJKKO (shkalla e parë) me nr nr. 112 dt. 20.10.2023 “për caktimin e masave të sigurimit”.
4. Vendimi i GJKKO (shkalla e parë) nr. 117, dt 26.10.2023 “për marrjennë pyetje të personit në hetim”,
5. Vendim i GJKKO (shkalla e dytë - Apeli) me nr. 56 (87-20-23-156), dt. 21.11.2023 “për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimeve të shkallës së parë”.

Me urdhrin nr. 3822/2, datë 11.12.2023, Kryetari i Kuvendit ka thirrur mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (këtu e në vijim Këshilli për Imunitetin), duke caktuar datën 18.12.2023, ora 12.00. Këshilli për Imunitetin zhvilloi një mbledhje në datën 18.12.2023.

Në mbledhje u shqyrtua kërkesa dhe relacioni i arsyetuar i prokurorisë, u konsultuan aktet provuese të ofruara nga organi i prokurorisë, u dëgjuan shpjegimet dhe përgjigjet e pyetjeve drejtuar 2 prokurorëve që përfaqësonin SPAK, si dhe u dëgjuan shpjegimet dhe përgjigjet e pyetjeve prej përfaqësuesve të deputeti Sali Berisha.

Pas shqyrtimit të akteve dhe diskutimit të çështjes sipas dispozitave të Kushtetutës në lidhje edhe me ato të Kodit të Procedurës Penale, anëtari i Këshillit për Imunitetin, nënshkrues i këtij relacioni, konkludoi se Seancës Plenare të Kuvendit, duhet t’i rekomandohet miratimi i dhënies së autorizimit për “Arrestimin/heqjen e lirisë, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit, ndaj deputetit të Kuvendit të Shqipërisë z. Sali Berisha”.

II. FAKTET

Nga kërkesa e paraqitur nga organi i Prokurorisë, Relacioni bashkëngjitur saj dhe përgjigjet e prokurorëve në mbledhje të Këshillit për Imunitetin rezultojnë se:

SPAK, ka regjistruar procedimin penal nr. 287 të vitit 2020 për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Më datë 02.10.2023, në kuadrin e këtij procedimi penal është vendosur, ndër të tjera, regjistrimi i emrit të personit nën hetim Sali Berisha, si i dyshuar se ka kryer veprën penale të: *“Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Kjo dispozitë parashikon se kërkimi ose marrja, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

Konkretisht, nga hetimet, vlerësohet se është krijuar dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova se personi nën hetim Sali Berisha, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, përgjatë periudhës kohore që shtrihet që nga viti 2005 e vijim, ka kryer veprime konkrete, aktive, në miratim ligjesh apo aktesh nënligjore, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familje ish-pronare, me qëllim kthimin dhe në vijim shfrytëzimin si troje ndërtimore të territoreve ku janë shtrirë ish Klubi Shumësportesh Partizani dhe ish Klubi i Futbollit Partizani, ku përfitues i drejtëpërdrejtë ndër të tjerë, rezultonte të ishte bashkëshorti i vajzës së tij, shtetasi Jamarbër Malltezi.

Nga ana e shtetasit Sali Berisha, janë kryer veprime aktive, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e kontroleve administrative (Urdhëri nr. 1289 prot., datë 16.04.2009), me qëllimin e ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhërave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin përfundimin e procesit të privatizimit, në favor ndër të tjera, të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i vajzës së tij.

Nga ana e shtetasit Sali Berisha, janë kryer veprime aktive, në cilësinë e tij si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, në vendosjen në dispozicion të shtetasit Jamarbër Malltezi, bashkëshorti i vajzës së tij, të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore në favor të tij.

Përfitimi i parregullt në favor të shtetasit Jamarbër Malltezi, në cilësinë e bashkëshortit të vajzës së Kryeministrit, shtetasit Sali Berisha, ekziston dyshimi se është, vetë privatizimi i objekteve sportive, me qëllimin e vetëm për t’u shtënë në dorë, ndryshuar destinacioni dhe përdorur për përfitime materiale nga shtetasi Jamarbër Malltezi.

Përfitim i parregullt, janë ndryshimet e kryera në lidhje me destinacionin e zonave nga sportive në të banimit, pavarësisht interesit publik që ekziston në lidhje me nevojën e ekzistencës së ambjenteve sportive, gjë që ka çuar në kryerje ndërtimesh, nga të cilat ka përfituar drejtëpërdrejtë shtetasi Jamarbër Malltezi.

Përfitim i parregullt, janë gjithashtu të gjitha përfitimet monetare që ka marrë shtetasi Jamarbër Malltezi nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k. para se të deklarohej si bashkëshortak në këtë shoqëri si dhe fitimet e akumuluar ndërsa vite të kësaj shoqërie dhe të shpërndara në vijim, pas deklarimit si bashkë-ortak, të llogaritura në shumën prej 672 976 832 lek ose 5 420 345 euro.

Vepra penale e korrupsionit pasiv, e cila ka në vetvete qëllimin e përfitimit, evidenton qartësisht se përfitimi mund të jetë jo vetëm për vete por edhe për persona të tjerë. Në rastin konkret, është evidentuar pikërisht se ky përfitim është marrë nga personi nën hetim Jamarbër Malltezi.

Neni 73 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012, ndryshuar paragrafi 3, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016), parashikon:

- 1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.*
- 2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.*
- 3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.*
- 4. Për çështjet e parashikuara në paragrafet 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur,*

Neni 288 i K.Pr.Penale, (Ndryshuar me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014 dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017) parashikon:

- 1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.*
- 2. Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij.*
- 3. Kur deputeti është arrestuar në flagrancë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin. Kur Kuvendi vendos heqjen e masës së arrestit në flagrance, deputeti lirohet menjëherë.*

Neni 289 i K.Pr. Penale “Lejimi për të kryer veprime” (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014, (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, date 30.03.2017) parashikon:

- 1. Mosdhënia e autorizimit, sipas nenit 288, të këtij Kodi, nuk e pengon prokurorin*

që të kërkojë një masë tjetër sigurimi, sipas nenit 244, dhe as të procedojë ndaj tij ose personave të tjerë, ndaj të cilëve zhvillohen hetime për të njëjtin fakt.

Mbështetur në sa më sipër, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke kërkuar caktimin e masave të sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “Ndalim i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, për personin nën hetim Sali Berisha.

Me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar masat e sigurimit personal të sipërcituara për personin nën hetim Sali Berisha.

Me vendimin nr. 117 datë 26.10.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka vendosur ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 112 datë 20.10.2023 ndaj personit nën hetim Sali Berisha, duke u urdhëruar ky i fundit të paraqitet të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00 para oficerit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe urdhërimi i këtij shtetasi të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233 pika 1 të K.Pr.Penale dhe ndalimi i përdorimit të pasaportës dhe dokumentave të tjera idnetifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

Duke mos qenë dakort me dy vendimet e mësipërme, nga ana e personit nën hetim dhe mbrojtësve të tij është ushtruar ankim. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, me vendimin nr. 56 datë 21.11.2023, ka vendosur ndër të tjera miratimin e vendimit nr. 112 datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të verifikuar me vendimin nr. 117 datë 26.10.2023 të së njëjtës gjykatë, ndaj ankuesit Sali Berisha.

Referuar proces verbaleve datë 06.11.2023, 20.11.2023 dhe 04.12.2023 të mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore/hetuesi, para të cilit duhet të paraqitej personi nën hetim Sali Berisha, rezulton se ky i fundit, nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës, duke mos u paraqitur asnjëherë para policisë gjyqësore.

Neni 289 i K.Pr. Penale “Lejimi për të kryer veprime” (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014), ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) parashikon:

...2. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo kur nga hetimet rezultojnë fakte ose rrethana të reja,

prokurori mund t'i kërkojë Kuvendit autorizim, sipas paragrafit 1, të nenit 288, të këtij' Kodi.

Neni 231 i K.Pr.Penale “Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal” parashikon:

“1. Në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese. ”

Neni 260 i K.Pr.Penale “Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit” parashikon:

...3. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese.

4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar sipas nenit 248, të këtij' Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6, i nenit 246, të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprake ose gjatë gjykimit.

Ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se, nga hetimet e kryera deri më tani, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova se nga ana e personit nën hetim Sali Berisha, është konsumuar vepra penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i K.Penal.

Vlerësojmë gjithashtu se, ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit dhe ekzistenca e këtyre kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 228, 229 të K.Pr.Penale, janë vlerësuar dhe konfirmuar tashmë nga gjykatat e posaçme.

Gjithashtu vlerësojmë se ndodhemi edhe në përmbushje të kërkesave të parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të K.Pr.Penale. Personi nën hetim Sali Berisha, në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore/hetuesit.

Mbështetur në sa parashtruar dhe shpjeguar më lart, bazuar në nenin 73 të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë, nenet 231, 260, 288, 289 të K.Pr.Penale, si dhe nenet 13, 118 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kërkojnë dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për arrestimin/heqjen e lirisë të deputetit Sali BERISHA, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e “Detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale, në atë të “arrestit në burg/arrest në shtëpi”, parashikuar nga nenet 238/237 të K.Pr.Penale.

Faktet e mësipërme, rezultojnë më të detajuara, prej akteve provuese, të depozituara nga ana e Prokurorisë, pranë Këshillit të Imuniteteve.

III. ANALIZA LIGJORE

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2012, që u frymëzuan nga nevoja për të intensifikuar luftën kundër pandëshkueshmërisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë, reformuan thelbësisht konceptin e imunitetit parlamentar. Rregullat e reja kushtetuese kanë tentuar të afrojnë zyrtarin e lartë shtetëror me qytetarin e zakonshëm në raport me përgjegjësinë penale dhe përgjegjshmërinë për zbatimin e ligjit. Një ndryshim i tillë, erdhi si nevojë, jo vetëm e një orientimi politik qeverisës në vitin 2012, por edhe si një detyrim për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe të disa marrëveshjeve ndërkombëtare, mes të cilave spikat “Konventa penale kundër korrupsionit” e GRECO-s.

Sipas rregullimeve normative, aktualisht deputeti ka vetëm 2 lloj imunitetesh në nivel kushtetues. Së pari, deputeti ka imunitet substancial dhe është i mbrojtur nga përgjegjësia “*për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit*”. Ky lloj imuniteti nuk ekziston për rastin e shpifjes.

Së dyti, deputeti ka imunitet procedural për lirinë e lëvizjes dhe për privacinë, që nënkupton se nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria, pa autorizimin e Kuvendit. Ndaj tij nuk mund të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Për kryerjen e këtyre veprimeve procedurale nevojitet autorizim i Kuvendit. Është ky shkak për të cilin, nga ana e Prokurorisë është paraqitur edhe kërkesa konkrete e marrë në shqyrtim nga Këshilli i Imuniteteve.

Imuniteti procedural përfaqëson një lloj pengese procedurale, që i shfaqet sipas rastit prokurorisë apo gjykatës, për të kryer veprime hetimore të lidhura me lirinë e lëvizjes dhe privatësinë e deputetit. Në njëfarë mënyre, imuniteti procedural mbron dinjitetin e deputetit, që atij të mos i cënohet liria dhe jeta private në mënyrë abuzive, pa patur një shkak të ligjshëm nga organet ligjzbatuese. Premisa bazë, që ligjëron heqjen e imunitetit

procedural është ekzistenca e procedimit penal të regjistruar sipas ligjit ndaj deputetit, që duhet të verifikohet nga Kuvendi. Në këtë pikëpamje, Kuvendi verifikon vetëm procedurën që është zhvilluar, pa i hyrë cilësisë dhe vlerës së provave në drejtim të faktit penal dhe të autorësisë. Imuniteti procedural nuk mundet dhe nuk duhet që në asnjë rrethanë të shndërrohet në një mburojë nga pandëshkueshmëria apo si pengesë për drejtësinë. Nëse pranohet e kundërta, atëherë çdo akt i prodhuar është absolutisht i pavlefshëm, sepse në mënyrë të dukshme Kuvendi tejkalon kompetencën e tij dhe merr kompetencë për ushtrim të paligjshëm të ndjekjes penale, pra uzurpon kompetenca gjyqësore. Nëse Kuvendi shqyrton prova dhe vlerëson besueshmërinë e tyre, atëherë demokracia përballet me një rrezik flagrant: rrënohet parimi i ndarjes së pushteteve i sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës! Jo vetëm kaq, por situata shtuhet dhe më pas sjell një tërësi pasojash, që dëmtojnë pa kthim parimet e drejtësisë dhe të shtetit, ku sundon ligji. Për ilustrim, nëse Kuvendi vlerëson provat, cilësinë e provave dhe shkallën e besueshmërisë së tyre, atëherë nuk ka bërë gjë tjetër veçse vlerëson mbi fajësinë ose pafajësinë e personit në hetim/gjykim, duke vendosur respektivisht prokurorinë dhe gjykatën përpara gjykimit të kryer, duke i shndërruar ato thjesht në noterë të vlerësimit të bërë nga Kuvendi. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse shkatërrim i parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë, ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor.

Në këtë terren kushtetues, në rastin konkret, është detyrë e Kuvendit të verifikojë nëse ekzistojnë të gjitha kushtet për dhënien e autorizimit, që kërkohet nga prokuroria për arrestimin e deputetit. Sipas nenit 288 të K.Pr.Penale, kërkesa për dhënien e autorizimit (për arrest, heqje lirie e çfarëdolloj forme, kontroll personal apo kontroll banese), paraqitet nga prokurori. Kërkesa për autorizim duhet të tregojë veprimin që kërkohet autorizimi (pra nëse do bëhet arrest, heqje lirie e çfarëdolloj forme, kontroll personal apo kontroll banese) dhe të tregojë se përmbushen kërkesat e Kodit për kryerjen e veprimit. Kërkesa për autorizim shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij. Ligji nuk kërkon që Kuvendi në procedurën e dhënies së autorizimit të vlerësojë cilësinë e provave apo shkallën e besueshmërisë së tyre. Kuvendi nuk mundet dhe nuk duhet të kryejë një proces të administrimit të provave të procedimit penal sepse ia ndalon këtë parimi i ndarjes së pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Është pushtet ekskluziv, vetëm i prokurorisë dhe i gjykatës, marrja, administrimi dhe vlerësimi i provave, për të krijuar bindjen nëse duhet ngritur akuzë dhe nëse i pandehuri duhet deklaruar fajtor dhe dënuar. Kuvendi, sipas Kushtetutës dhe Kodit të Procedurës Penale nuk ka të drejtë dhe nuk i është njohur kompetenca të verifikojë, ai vetë, provat e një procedimi penal, të vlerësojë besueshmërinë e tyre dhe të deklarojë nëse provohet fakti penal dhe autorësia e të dyshuarve.

Një qëndrim i tillë i tillë i Kuvendit, mbështetet dhe nga aktet ndërkombëtare, të dedikuara ndaj kësaj veprimtarie parlamentare, më i spikaturi prej të cilave është dokumenti i Komisionit të Venecias, “Raporti mbi qëllimin e lënies së imunitetit parlamentar” CDL-AD(2014)011, i cili në paragrafin 168 përshkruan se:

“168. Komisioni i Venecias për më tepër vlerëson se organi parlamentar që shqyrton një kërkesë për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një shqyrtim ligjor të çështjes. Në veçanti ai nuk duhet në asnjë rrethanë, të deklarojë vetë mbi fajësinë ose jo të deputetit në fjalë, ose nëse ndjekja penale është e bazuar. Vendimi duhet të bazohet mbi faktet dhe meritat e çështjes siç i parashtrajnë autoritetet dhe deputeti në fjalë dhe jo mbi konsiderata të tjera politike apo të jashtme. ...”

Kuvendi, në cilësinë e pushtetit legjislativ, në këtë lloj procedure ka vetëm një detyrë: të sigurojë që deputeti në procedurë të mos jetë peng i përdorimit abuziv politiko-partiak për shkak të veprimtarisë së tij parlamentare.

Një qëndrim i tillë i tillë i Kuvendit, mbështetet nga dokumenti i mësipërm i Komisionit të Venecias i cili në paragrafin 162 përshkruan se:

162. Komisioni i Venecias, në përgjithësi, konsideron se duhet të ketë një prezumim bazik që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet në të cilat nuk ka arsye të besohet se akuzat kundër deputetit në fjalë janë të motivuara politikisht. Imuniteti duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye të dyshohet për një element politiko-partiak në vendimin për të ndjekur penalisht parlamentarën në fjalë. ...”

Në funksion të këtij qëllimi, Kuvendi, në këtë lloj procedure verifikon:

Së pari ekzistencën e një procedimi penal të ligjshëm;

Së dyti ekzistenca e kushteve ligjore për arrestin dhe kontrollin.

Së treti në vlerësimin e këtyre kushteve, Kuvendi, duhet të vlerësojë nga ana përmbajtësore disa kritere të listuara saktësisht nga dokumenti i mësipërm i Komisionit të Venecias, në paragrafët 188 dhe 189 si më poshtë:

“188. Kur vendos nëse imuniteti parlamentar duhet të hiqet apo jo në një rast konkret duhet të merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

Kritere për mbajtjen e imunitetit:

- kur pretendimet janë qartazi dhe haptazi të pabazuara

- kur shkelja e pretenduar është një pasojë e paparashikuar e një veprimi politik

- kur pretendimet janë paraqitur qartësisht për motive politiko-partiake (fumus persecutionis) me qëllim shqetësimin ose intimidimin e deputetit ose ndikimin tek mandati i tij
- kur procedurat ligjore mund të rrezikojnë seriozisht funksionet demokratike të parlamentit ose të drejtat themelore të një deputeti ose grup deputetësh

189. Kriteret për heqjen e imunitetit:

- kur kërkesa bazohet në shkaqe të drejta të rëndësishme dhe të sinqerta
- kur shkelja e pretenduar është e një natyre veçanrisht të rëndë
- kur kërkesa lidhet me sjellje kriminale që nuk lidhet ngushtësisht me përmbushjen e funksioneve parlamentare por lidhet me akte të tjera të kryera në funksione të tjera personale ose profesionale
- kur procedurat duhet të lejohen me qëllim që të mos pengohet drejtësia
- kur procedurat duhet të lejohen me qëllim garantimin e autoritetit dhe legjitimitetit të parlamentit.”

Nga analizimi i këtyre kushteve dhe kriterëve, të aplikuara në rastin e kërkesës konkrete të paraqitur nga ana e organit të Prokurorisë rezulton se:

1. Ekzistenca e një procedimi penal të ligjshëm

Ky kusht kërkon që Kuvendi të verifikojë se ndaj deputetit ka një procedim penal, që procedimi penal të jetë filluar për vepra penale që ligji i parashikon si të tilla dhe që organi i cili po procedon të ketë kompetencën e dhënë nga ligji për procedimin e veprave penale të tilla.

Nga analiza e kërkesës së prokurorisë, relacionit shoqërues të prokurorisë, përgjigjeve të prokurorëve në mbledhje të Këshillit për Imunitet konstatohet pa asnjë dyshim ekzistenca e procedimit penal ndaj deputetit Sali Berisha. Ky procedim është regjistruar në vitin 2020, me numër 287 në SPAK. Përpos kësaj, nga ana e SPAK është proceduar më kërkesë drejtuar GJKKO, për caktimin e masave të arrestit. GJKKO (shkalla e parë dhe apeli) në përfundim kanë konfirmuar ndër të tjera qoftë ekzistencën e procedimit penal, e qoftë edhe vendosjen e masave të sigurimit të llojit shtrënguese (dy masa sigurimi). Rrjedhimisht, nxirret përfundimi se plotësohet kushti ligjor se ndaj deputetit Sali Berisha ekziston një procedim penal i rregullt nga pikëpamja e parimit të ligjshmërisë.

2. Ekzistenca e kushteve ligjore për arrestin

Ky kusht kërkon që Kuvendi të verifikojë nëse kërkesa dhe relacioni i Prokurorisë për Krime të Rënda tregojnë qartë se ekzistojnë kushtet ligjore për arrestin e deputetit.

Nga analiza e kërkesës së prokurorisë, relacionit shoqërues të prokurorisë, përgjigjeve të prokurorëve në mbledhje të Këshillit për Imunitetin konstatohet pa asnjë dyshim se kërkesa e prokurorisë tregon qartë kushtet ligjore për veprimet e arrestit dhe të kontrollit, në përputhje me nenin 288 të K.Pr.Penale. Duhet saktësuar se SPAK në relacion, kërkon dhënien e autorizimit, për masën e arrestit/heqjes së lirisë, si zëvendësim, të dy masavë të mëparshme të dhëna nga GJKKO, dhe jo si një masë e kërkuar në instancë të parë. Në relacion është saktësuar se dispozitat përkatëse, mbi të cilat bazohet SPAK janë hipotezat e parashikuara nga nenet 231/1 dhe 260/3 të KPP. Në objektin e kërkesës e kanë sqaruar duke u shprehur se kërkojnë “*dhënien e autorizimit...për arrestimin/heqjen e lirisë, ...nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit nga ajo e “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”..dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, në atë të arrest në burg/arrest në shtëpi..”*”.

Kjo do të thotë që përpos të gjitha kritereve të zakonshme që Kuvendi duhet të analizojë, duhet të shtohet edhe analiza faktike dhe ligjore e hipotezes së “zëvendësimit” të masave të mëparshme me masat e reja.

Më konkretisht, në kërkesën e prokurorisë, e saktësisht në vendimet gjyqësore, ku ajo mbështetet dhe në procesverbalet e oficerit të policisë gjyqësore (i ngarkuar me kontrollin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga masat e sigurimit në fuqi) evidentohen qartazi kushtet e neneve 228, 229, 230 dhe nenet 231/1 e 260/3 të K.Pr.Procedurës Penale, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

a) Dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova

Ndaj deputetit Sali Berisha ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet. Ky dyshim i arsyeshëm, është i konfirmuar jo vetëm nga veprimtaria hetimore e SPAK, por për më tepër edhe nga vendimet e GJKKO, teksa kjo e fundit ka miratuar masat e sigurimit që janë në fuqi. Kuvendi, në asnjë rast nuk ka kompetencë të analizojë themelin për konceptin e “dyshimit të arsyeshëm”. Ai duhet të mjaftohet që nga ana e organit të prokurorisë janë dokumentuar, akte administrativo-hetimore në kuadër të procedimit penal, pra veprimtari faktmbledhëse, që krijojnë dyshimin se mund të ndodhet në situatën ligjore të shkeljes eventuale të një dispozite penale. Është një kufi i qartë, ai sipas të cilit një organ jo gjyqësor, sic është Kuvendi, (dhe askush tjetër në fakt, përveç gjykatave) nuk ka asnjë të drejtë të marrë nën shqyrtim apo kontroll masën e dyshimit, mbi të cilin prokuroria ka vendosur të nisë një procedim penal. Është kompetencë vetëm i organit procedues (dhe eventualisht gjykatës). Për më shumë në rastin konkret, masa e

dyshimit, arsyeshmëria e tij, bazueshmëria në fakte, dhe masa sasiore apo cilësore e provave, kanë kaluar edhe në testin e gjykatës, të shkallës së parë dhe të apelit (GJKKO), të cilat e kanë konfirmuar këtë konsideratë fillestare të SPAK. Ndaj, për më shumë, në këtë rast Kuvendi, nuk ka asnjë kompetencë të ndërhyjë në vlerësimin që edhe gjykatat kanë marrë.

Për të gjitha këto arsye, konsiderohet i përmbushur standardi i “dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova” për rastin konkret.

b) Rreziku përkundrejt procedimit

Kërkesa tjetër ligjore që duhet marrë në analizë është edhe nëse ekziston “rreziku përkundrejt procedimit”. Vendosja e masave të sigurimit, nuk duhet mbështetur vetëm në konsideron se “ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale”. Ky kriter është baza, për të filluar procedimin penal, por i vetëm nuk mjafton që ndaj personit nën hetim të aplikohen edhe masa sigurimi personal. KPP, ka parashikuar, që këto masa sigurimi vendosen nëse, ekziston së paku një nga tre rrethanat: 1- rreziku i fshehjes ndaj drejtësisë; 2- rreziku i dëmtimit të veprimtarisë faktmbledhëse (e quajtur rëndom si “prishje e provave”; dhe 3- rreziku që lënia në liri e personit nën hetim, mundëson prej tij kryerjen e veprave penale si ajo për të cilin hetohet. Edhe ky “rrezik” në instancë të parë vlerësohet nga ana e organit të prokurorisë, e më pas nga ana e gjykatës. Pozicioni i Kuvendit, në këtë rast, është i ngjashëm me atë që duhet të mbajë në rastin e analizës së “dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale”. I vetmi përjashtim, është konsiderata e natyrës politiko-parlamentare, sipas së cilës, dhënia/modhënia e autorizimit për procedim, të mos konsiderohet si instrument i luftës politike (analiza e këtij kriteri, bëhet më poshtë në pikën 3). Përsa i përket “rrezikut përkundrejt procedimit” rezulton në këtë rast se Kuvendi, nuk duhet edhe njëherë të vlerësojë, rishqyrtojë, kontrollojë vlerësimin që prokuroria ka bërë. Kuvendi duhet të mjaftohet me faktet, nëse prokuroria ka treguar në kërkesë dhe relacion, se ajo ka arritur në konkluzionin, se sipas optikës së saj, ekziston ky rrezik. Kjo analizë duhet të jetë e shprehur qartë në kërkesë dhe relacion. Në rastin konkret prokuroria e ka analizuar një rrezik të tillë. Madje në rastin në fjalë ky “rrezik përkundrejt procedimit” është konfirmuar edhe nga GJKKO (dy shkallë). Është i vertetë edhe fakti tjetër se ky rrezik përkundrejt procedimit, e ka shtyrë prokurorinë që të kërkojë (e pastaj gjykata ka dhënë) masa sigurimi si “ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe “detyrimi për paraqitje para policisë gjyqësore” të cilat sipas gravitetit dhe proporcionalitetit (në raportin rrezik – kufizim) nuk janë të njëjta me atë rrezik që do të përkonte masës së arrestit. Gjithësesi ky është një vlerësim që është diskrecion fillimisht të prokurorisë e më pas edhe të gjykatës. Për Kuvendin është i rëndësishëm fakti që ky rrezik ekziston dhe kjo të jetë e shtjelluar-

analizuar në kërkesë. Sa i rëndë është ky rrezik, dhe cila masë do të ishte e përshtatshme (proporcionale), nuk është kompetencë e Kuvendit. Përndryshe do krijohet një situatë juridike e tejkalimit qoftë të kompetencës ligjore e akoma më shumë edhe kufijve kushtetues juridiksionale (bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve).

c) Papërshtatshmëria e masave të tjera - proporcionaliteti.

Lidhur me këtë kriter, qëndrimi i Kuvendit duhet të jetë ai më sipër (pika “b”). Është prokuroria dhe më pas gjykata që kanë aftësinë e njohur ligjërish, për të vlerësuar proporcionalitetin. Kuvendi nuk mund të ndërfitet në këtë vlerësim.

Në rastin konkret duhet saktësuar, se kërkimi i autorizimit, bazohet në një hipotezë të ndryshme nga nenet 228-229 të KPP. Pra jo si një kërkesë në instancë të parë për arrestin (burg/shtëpi), por si një derivat i mospërmbushjes së detyrimeve të masave të tjera të sigurimit (detyrim paraqitje/ndalim moslargimi nga territori). Kjo hipotezë derivative buron nga dy dispozita të KPP, respektivisht neni 231/1 dhe 260/3 të KPP. Këto dispozita bëjnë fjalë për zëvendësim të masave të mëparshme. Neni 260/3 parashikon se zëvendësimi me trend rëndues bëhet ose kur “rreziku perkundrejt procedimit” në vetvete është shtuar ndërkohë (nga momenti fillestar i caktimit të masave të mëparshme) ose kur, thjesht nuk zbatohen detyrimet e masave tashmë të vendosura më parë. Kjo çështje është saktësuar nga ana e prokurorisë pas pyetjeve drejtuar asaj, e sipas tyre, zëvendësimi kërkohet për faktin se personi nën hetim nuk ka zbatuar detyrimet që rëndonin nga masat e mëparshme. Për këtë shkak edhe prokuroria ka ofruar si prova edhe 3 procesverbalet e mbajtura nga oficeri i policisë gjyqësore (të cituara më lart). Në këto kushte rezultoi e provuar fakti se personi nën hetim nuk ka zbatuar detyrimet që rëndonin mbi të, caktuar me vendim gjykate, në mënyrë të përsëritur. KPP, në nenin 231/1 dhe 260/3, ia lë në diskrecion prokurorisë si mundësi të kërkojë ose jo një “masë tjetër më të rëndë” sesa të mëparshmet. Mesa duket qartazi prokuroria ka zgjedhur opsionin që në mungesë të respektimit të masave të mëparshme të kërkojë një masë tjetër më të rëndë. Në këtë pikë përsëri, Kuvendi nuk ka të drejtë të vlerësojë nëse është e vlerësuar drejt apo jo kjo nevojë-mundësi, kjo zgjedhje e prokurorisë. Edhe ky kriter bie nën suazën kontrolluese të juridiksionit gjyqësor. Nëse do ndodhë që Kuvendi do japë autorizimin, do të jetë gjykata ajo që do të vlerësojë nëse ka vend apo jo për një masë më të rëndë bazuar në proporcionalitetin shkelje – rëndim mase. Për Kuvendin është i rëndësishëm fakti, që premisa bazë, ajo e shkeljes së detyrimeve të mëparshme është e provuar. Nëse gjykata do ta gjejë me vend kërkesën, është kompetencë e saj, porse Kuvendi, duhet të mos ndërhyjë në këtë kompetencë gjyqësore me mosdhënien e autorizimit të kërkuar.

3. Vlerësimi i kriterëve për lënien ose mbajtjen e imunitetin (kriteret e Komisionit të Venecias):

Në vlerësimin në themel të çështjes për mbajtjen ose jo të imunitetit në këtë rast, duke u bazuar në rrethanat e faktit të përshkruara në materialet e paraqitura nga ana e prokurorisë, lehtësisht vërehen plotësimet e kriterëve, në favor të dhënies së autorizimit (heqjes së imunitetit) duke arritur në konkluzionet për secilin kriter si më poshtë:

- pretendimet e prokurorisë nuk janë as haptazi dhe as qartazi të pabazuara. Ajo ka shoqëruar kërkesën e vetë më relacionin përkatës dhe më një numër provash në kuptim të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër ky material provues është i testuar dhe i verifikuar gjyqësisht edhe nga proceset gjyqësore (vendimet e shkallës së parë dhe vendimi i apelit).
- Akuzat e ngritura nga ana e prokurorisë dhe kërkesa e saj për dhënie autorizimi (heqjen e imunitetit) nuk bazohen në ndonjë veprimtari aktuale politike të deputetit, por rolit si zyrtar (kryeministër) kohë më parë.
- Shkeljet penale që deputetit i atribuohen, në mënyrë të qartë nuk janë të bazuara në motive politiko-partiake dhe as kanë për qëllim shqetësimin apo intimidimin e deputetit apo ndikimin në mandatin e tij. Nga vetë deputeti (përfaqësuesit e tij) as nuk u pretendua një motiv i tillë politik. Për me shumë është pohuar publikisht, prej tij, respektimi i vendimmarrjes së Kuvendit, si shenjë e një qëndrimi dinjitoz politik.
- Heqja e mandatit të deputetit, nuk e vë në rrezik serioz funksionin demokratik të parlamentit as edhe të drejtat themelore të vetë deputetit apo ndonjë grupi parlamentar.
- Vetë kërkesa për dhënie autorizimi (heqje imuniteti) është përshkruar në aktet e prokurorisë se bazohet në shkaqë të drejta, të rëndësishme dhe të singerta. Ato kanë lidhje me procedimin penal, bëhen në funksion të tij, si nevoja të domosdoshme për t'u kryer.
- Shkelja e pretenduar nga ana e prokurorisë (akuzat) janë veçanërisht të rënda.
- Shkelja që i atribuohet deputetit e për të cilat kërkohet heqja e imunitetit, nuk është pasojë e veprimtarisë së tij si parlamentar (ka qenë në funksionin e kryeministrit).
- Dhënia e autorizimit (heqja e imunitetit) është një barrierë e vërtetë e cila nëse nuk realizohet, atëherë verifikohet një pengim real i drejtësisë.

- Mosdhënia e autorizimit, është një akt i cili kompromenton tërësisht autoritetin dhe legjitimitetin e parlamentit në sytë e publikut dhe në marrëdhëniet institucionale me organet e tjera.

Vecanërisht, në arritjen e këtij konkluzioni, arrita edhe duke qenë i ndërgjegjshëm për impaktin që do të kishte mosdhënia eventuale e autorizimit sipas kërkesës së prokurorisë.

Në një version të tillë, do të rezultonte se mbajtja apo ruajtja e një imuniteti të tillë në vetvete është një cënim i parimit kushtetues të barazisë para ligjit, i cili është thelbi i vetë Shteti të së Drejtës. Maksima “sado lart që ti të jesh, ligji është gjithnjë mbi ty” përmbysset duke u shndërruar në “nëse je anëtar i Parlamentit, ligji nuk mund të të prekë”. Ky do të ishte sinjali më i gabuar që Parlamenti kurrësi nuk duhet ta emetojë ndaj publikut të tij.

Së dyti, vetë rregullat e imunitetit, në thelbin e tyre kanë potencialin e madh që të keqpërdoren nga deputetët, dhe të shndërrohen prej tyre në një strehë të ngrohtë për t’u mbrojtur nga shkeljet e ligjit prej tyre. Një vendimmarrje e tillë do të shërbente si një incentiv për të tërhequr në strehën e parlamentit njerëz më rekorde kriminale apo korruptive, plagë e madhe kjo dhe shume e freskët dhe aktuale e politikës aktuale shqiptare.

Së treti, rregullat e imunitetit në vetvete, dhe për më shumë akoma një vendimmarrje për mbajtjen e imunitetit në rastin konkret do të minonte besimin e publikut te Parlamenti si institucion dhe do të krijonte përçmim për politikën, politikanët dhe vetë sistemin politik. Kuvendi, pa asnjë dilemë, duhet të miratojë dhënien e autorizimit sepse vetëm në këtë mënyrë, secili prej deputetëve veçmas, por edhe Kuvendi si një i tërë tregon standardin më të lartë të sjelljes etike dhe bëhet model për të tërhequr në mjedisin politik njerëz të rinj dhe me vlera.

Së katërti, vetë procedura e heqjes së imunitetit, mbart me vete probleme parimore kushtetuese për disa arsye:

- i. nuk është e lejueshme prej Kushtetutës, që anëtarët e Parlamentit të shqyrtojnë brendinë e informacionit të mbledhur nga prokuroria dhe ta vlerësojnë atë, pasi atyre nuk iu lejohej të njihen më të dhëna private për deputetin në fjalë.
- ii. deputetëve nuk iu lejohej të shqyrtojnë themelin e fajësisë apo pafajësisë, cilësinë e provave, bazueshmërinë në to, sepse kështu do të cënohej parimi i prezumimit të pafajësisë ashtu sic e kërkon edhe Konventa Europiane te Drejtave të Njeriut. Në këtë rast Kuvendi vetë të cënonte procesin hetimor dhe gjyqësor eventual që Prokuroria ka ndërmarrë duke shkelur parimin e procesit të rregullt

ligjor, e kështu kjo do të ishte njolla e zezë më e madhe për Parlamentin e një vendi, vështirësisht e shlyeshme.

- iii. po ashtu, do të çenohej edhe parimi i ndarjes së pushteteve nëse deputetët do të shqyrtonin themelin e fajësisë apo pafajësisë.

Së pesti, nëse Kuvendi voton për mbajtjen e imunitetit dhe për pengimin e drejtësisë, ky veprim do të ishte goditja më energjike ndaj shpresës së publikut dhe aksionit politik brenda dhe jashtë vendit për Reformën në Drejtësi.

Së gjashti, mbajtja e imunitetit nga Kuvendi në rastin konkret tregon haptazi mungesë vullneti politik për të mbështetur përpjekjet e drejtësisë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar e rrjedhimisht, përbën një hap pas në rrugën e integritit evropian të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, Kuvendi do të godiste fort pritshmëritë dhe përpjekjet e shoqërisë shqiptare për t'iu bashkuar familjes evropiane, e cila i ka vënë (politikës më së pari) ndër të tjera edhe kushtin për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Së shtati, duhet krijuar, nëpërmjet këtyre precedentëve parlamentarë standardi etiko-politik, në trajtimin e çështjeve të tilla. Në 15 vjetet e fundit të jetës parlamentare, Kuvendi ka dështuar ta krijojë/konsolidojë këtë standard. Jam me bindjen e palëkundur, se votimi për dhënien e autorizimit në këtë rast, shërben, që edhe për rastet e tjera të së ardhmes do të destinohet i njëjti trajtim, pavarësisht përkatësisë politike parlamentare. Standardi në fjalë është: asnjë imunitet për parlamentarët dhe qeveritarët! Në këtë mënyrë, do të mund të rikuperohet politikisht standardi politik që Partia Demokratike, dikur në qeverisje vendosi: atë të lënies me dëshirë të imunitetit, sa herë kërkohej nga drejtësia.

Së fundmi, nuk mund të anashkaloj edhe raportin njerëzor që krijohet mes kolegësh deputetë. Pavarësisht rreshtimit politik, pavarësisht qëndrimeve partiake, pavarësisht divergjencave dhe qëndrimeve antitetike të kohërave politike më të fundit, marrëdhënia njerëzore është e jo e papërfillshme. Aq më shumë kur bëhet fjalë që me deputetin, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, kam ndarë për shumë kohë, (sidomos për periudhën kohore përgjatë së cilës vendosen kronologjikisht faktet e pretenduar si penale), të njëjtën anë të pozicionimit politiko-partiak, të njëjtat angazhime qeverisëse apo parlamentare. Megjithatë përgjegjësia e lartë, e pozicionit të deputetit të Kuvendit, kur thirret në situata të tilla delikate si në aspektin emotiv, ashtu edhe atë politik e më së shumti ligjore, duhet të prevalojë qoftë mbi brengat njerëzore që natyrshëm krijohen, qoftë mbi përllogaritjet e vogla partiake që bashkëshoqërojnë pandashëm aktivitetin politik apo solidaritetin partiak. Angazhimi si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, mbart si një vlerë të patjetërsueshme, komponentin e mbrojtjes së interesit publik dhe të gjithë vendit. Duhet të jetë ky pozicionimi politik i epërm, mbi të cilin duhet gjetur objektiviteti dhe shpirtqetësia në

ndërmarrjen e një konkluzioni për gjykimin mbi pozitën politike dhe imazhit publik të cdo përfaqesuesi të lartë politik. E në kushtet, kur pranoj se së paku në imazhin publik, vendosja (apo vetvendosja) e një deputeti para situatës kur duhet t'i nënshtrohet drejtësisë, e krijon një bjerrje të imazhit apo goditje të vleresimit që publiku ka pas krijuar për të, zgjedh të vendos se zgjidhja optimale, pragmatiste, politike dhe etike që figura publike e atij deputeti, të rikuperohet, të ruhet, mbrohet, ndoshta të përforcohet është ajo që tejkalon domosdoshmërisht testin e drejtësisë. E gjykoj si një mundësi të mirë për ruajtjen e dinjitetit politik të deputetit në fjalë, përballjen me drejtësinë.

Thënë e gjitha kjo sa më lart, besoj se krijohet premisa, sot dhe në të ardhmen, që situata të tilla të trajtohen njëjloj, e ndoshta kështu krijohet edhe pjekuria publike dhe ajo politike që të mos shihet e nevojshme në ligje dhe Kushtetutë të ruhen hije të imunitetit duke e abroguar atë plotësisht apo edhe faktikisht. Është detyrim im në cilësinë e deputetit të kontribuoj në këtë drejtim.

Në sintezë të të gjithë analizës ligjore, dëshiroj të evidentoj se në nxjerrjen e rekomandimit u mbështeta pikë së pari, në ruajtjen e interesit publik, në mbrojtjen e imazhit të politikës, në mospengimin e drejtësisë, në mosndërhyrjen e kompetencave të sistemit të drejtësisë dhe në dhënien e mundësisë vetë deputetit të cilit i kërkohet heqja e imunitetit, që të pastrojë figurën e vetë politike, në mënyrë të padyshimtë, nga një autoritet i pavarur dhe i paanëshëm sic është sistemi i drejtësisë.

IV. KONKLUZIONE

Përfundimisht, si anëtar i Këshillit për Imunitetin, i rekomandoj seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të votojë, për miratimin kërkesës për dhënien e autorizimit, të kërkuar me shkresën nr. 16688 prot., datë 12.12.2023 të SPAK “Për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.

DEPUTETI
ENKELEJD ALIBEAJ